



Përmbajtja:

Tetor 2023 - Maj 2024

Projekti "Statistika të Forta Vendore Shqiptare" SALSTAT II është pjesë e projektit "Bashki të Forta", financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) që zbatohet në periudhën tetor 2022 - shtator 2026. Projekti "Bashki të Forta" përqendrohet në aspekte të ndryshme të zhvillimit vendor në Shqipëri, duke mbështetur decentralizimin dhe qeverisjen vendore.

Palët kyçe të interesit në këtë projekt janë INSTAT-i, bashkitë, si dhe disa ministri të linjës e agjenci qeveritare, veçanërisht ato që janë përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave statistikore dhe/ose janë përgjegjëse për të dhënat/regjistrat administrativë.

Gjatë fazës së re, SALSTAT do të intensifikojë bashkëpunimin me bashkitë dhe agjencitë e tjera shtetërore për të forcuar besimin tek statistikën zyrtare dhe për t'u angazhuar me palët e interesit lidhur me përfitimet nga statistikën zyrtare, për qeverisjen demokratike dhe procesin e vendimmarrjes, veçanërisht sa i përket përmbushjes së detyrave, përgjegjësisë dhe funksioneve të bashkive.

- Plani Vjetor i Aktiviteteve i Projektit SALSTAT II për vitin 2024;
- Seminar për "Strategjinë e Sistemit Statistikor Kombëtar" të INSTAT-it miratuar me ligjin Nr. 30/2022 "Programi i Statistikave Zyrtare 2022-2026";
- Shpërndarja e Vjetarit Statistikor në Qarqe dhe në Bashki;
- Rikonfigurimi i sistemit parësor të qendrës së të dhënave; blerja e licencave të programeve Microsoft për përdoruesit dhe serverët. Shkëmbimi në internet (plani 2);
- Regjistri Statistikor Shqiptar i Godinave dhe Banesave;
- Sinergjia ndërmjet SALSTAT-it dhe Projektit Bashki të Forta të HELVETAS-it;
- Organizimi / zhvillimi i trajnimeve sipas Modullit 3: Njohuri për tabulimin dhe analizimin e të dhënave (nivelet fillestare dhe të avancuara në Excel).

Plani Vjetor i Aktiviteteve i Projektit SALSTAT II për vitin 2024

Më 13 nëntor 2023, u organizua një seminar me stafin e INSTAT-it në lidhje me Planin Vjetor të Aktiviteteve (PVA) 2024 për Projektin SALSTAT. Diskutimet kryesore u përqendruan në:

- Prapaveprime dhe mësimet e marra gjatë vitit 2023 (SALSTAT)
- Rezultati 1: Të dhëna dhe tregues më të gjerë statistikorë vihen në dispozicion të bashkive dhe qarqeve me anë të instrumenteve moderne për mbledhjen e të dhënave dhe shpërndarjen/diskutimin e veprimtarive të planifikuara dhe risqeve
- Rezultati 2: Zbatimi i elementeve kyçe të një sistemi të harmonizuar me bazë regjistrat për statistikat e popullsisë/familjeve dhe godinave/banesave. Diskutime për veprimtaritë e planifikuara dhe risqet
- Rezultati 3: Bashkitë mbështeten për të zhvilluar aftësitë dhe kapacitetet e tyre statistikore dhe janë më të ndërgjegjshme lidhur me rolin e statistikave zyrtare në Shqipëri / Diskutime për veprimtaritë e planifikuara dhe risqet
- Diskutime (përdorimi i të dhënave të censit për SALSTAT-in, analizë për bashkitë dhe palët e interesit 2024/2025).

Pas diskutimeve në seminar, ekipi i SALSTAT-it ripërpunoi projekt dokumentin e PVA-së për vitin 2024 dhe e përfundoi dokumentin në fjalë sipas propozimeve dhe marrëveshjeve të arritura gjatë seminarit.



PVA-ja për vitin 2024 u paraqit gjatë Mbledhjes së Komitetit Drejtues (MKD) dhe u miratua nga të gjithë anëtarët me të drejtë vote.

Seminar për "Strategjinë e Sistemit Statistikor Kombëtar" të INSTAT-it miratuar me ligjin Nr. 30/2022 "Programi i Statistikave Zyrtare 2022-2026"

Sipas planifikimeve, më 24 dhe 25 janar 2024 u organizua Seminari për "Shkëmbimin dhe përfshirjen e objektivave dhe rezultateve të SALSTAT-it në "Strategjinë Kombëtare të Sistemit të Statistikave" të INSTAT-it".

Pjesa e parë e seminarit trajtoi treguesit e performancës së INSTAT-it, që janë instrumente për matjen e performancës së institucionit. Kjo veprimtari është me rëndësi për raportimin në Kuvendin e Shqipërisë në të ardhmen, në kuadër të planit vjetor të punës së INSTAT-it dhe të strategjisë kombëtare. Tre shtyllat e INSTAT-it (infrastruktura, prodhimi dhe përdoruesi) dhe treguesit e propozuar u diskutuan në grupe të ndryshme pune.

Pjesa e dytë e seminarit u përqendrua në veprimet që do t'i mundësojnë veprimtarive të SALSTAT-it dhe atyre në kuadër të integritetit në BE (Kapitulli 18) të përfshihen në Strategjinë Kombëtare të Sistemit të Statistikave të INSTAT-it.



Shpërndarja e Vjetarit Statistikor në Qarqe dhe në Bashki

Sipas kalendarit të botimeve, më 15 dhjetor 2023 INSTAT botoi në faqen e vet zyrtare Vjetarin Rajonal Statistikor 2023 si në shqip, ashtu edhe në anglisht. Libri i botuar është i disponueshëm në adresat e mëposhtme:

Anglisht: <https://www.instat.gov.al/en/publications/books/2023/regional-statistical-yearbook-2023/>

Shqip: <https://www.instat.gov.al/al/publikime/librat/2023/vjetari-statistikor-rajonal-2023/>

Projekti vijoi me procedurat për shtypjen e librit në fjalë dhe do ta shpërndajë atë gjatë tremujorit të parë të vitit 2024 tek të gjitha palët e interesit, përfshirë bashkitë.

Rikonfigurimi i sistemit parësor të qendrës së të dhënave; blerja e licencave të programeve Microsoft për përdoruesit dhe serverët.

Më 31 janar të vitit 2024, INSTAT ra viktimë e **një sulmi kibernetik të orkestruar nga grupi iranian i quajtur 'Homeland Justice' (Drejtesia e Atdheut)**. Sulmi synoi infrastrukturën digjitale të INSTAT-it duke sjellë shqetësime lidhur me integritetin e të dhënave, fshehtësinë dhe ndërprerjet e mundshme të operacioneve të institucionit.

Ky sulm rezultoi në përgjigje urgjente nga ana e institucionit, i cili filloi bashkëpunimin aktiv me specialistët e Agjencisë Shtetërore të Sigurisë Kibernetike për identifikimin e shkaqeve, vlerësimin e ndikimit dhe veprimet e shpejta për rikthimin në normalitet.

Si pasojë e sulmit kibernetik, gjatë takimit me donatorët e organizuar më 22 shkurt 2024, SDC-ja shprehu mbështetjen e saj për fuqizimin e sigurisë kibernetike dhe rivendosjen e komunikimit të brendshëm/jashtëm sipas kërkesave të INSTAT-it lidhur me rikonfigurimin e sistemit parësor të qendrës së të dhënave dhe blerjen e programeve Microsoft për përdoruesit dhe serverët.

Gjatë muajit mars 2024, u krye procedura administrative e prokurimit përfshirë shqyrtimin e procesit nga ana e auditit financiar dhe marrjen e "mos-kundërshtisë" nga Ambasada në lidhje me përfundimin e procedurave për prokurimin e licencave dhe shërbimeve të nevojshme për funksionalizimin e tyre.

Titulli i kontratës është "Mbështetje financiare për rikonfigurimin e infrastrukturës të Qendrës Parësore të të Dhënave të INSTAT-it, Blerjen e Microsoft Endpoint për serverët dhe përdoruesit, si dhe të Exchange Online".

SALSTAT II ka mbështetur INSTAT me blerjen e licencave të Microsoft TEAMS me qëllim modernizimin e komunikimit ndërmjet selisë qendrore të INSTAT dhe Zyrave Rajonale, për një periudhë dy vjeçare (deri në maj të vitit 2025).

Nga dhjetori i vitit 2022 deri në shkurt të vitit 2024 projekti mbështeti INSTAT-in edhe për Mirëmbajtjen e Serverit të sistemit rezervë.

Regjistri Shqiptar Statistikor i Ndërtesave dhe Banesave

Në kuadër të Projektit SALSTAT, INSTAT po zbaton krijimin e një Regjistri Shqiptar Statistikor të Ndërtesave dhe Banesave (RShSNB).


Eksperti i RShSNB-së kreu dy misione në INSTAT gjatë periudhës tetor 23 mars 24.

- Më 23 nëntor 2023, u zhvillua në Tiranë "Seminari i nivelit të mesëm për zbatimin e TI-së" për Regjistrin Shqiptar Statistikor të Ndërtesave dhe Banesave.
- Më 6 mars 2024 u zhvillua në Tiranë seminari "Paraqitja e fazës aktuale të zhvillimit të TI-së, veçanërisht panelit të dhe sistemit të administrimit të RShSNB-së".

Mandati i tij lidhet me produktin e planifikuar "2.2: Zbatimi i një regjistri statistikor funksional të ndërtesave dhe banesave" dhe është pjesë e veprimtarisë "2.2.3 Ngritja e infrastrukturës TI dhe strukturës përkatëse të ndërfaqes së të dhënave për transmetimin e të dhënave ndërmjet INSTAT-it dhe institucioneve qeveritare përkatëse".

Gjatë seminarit të nëntorit, eksperti paraqiti situatën aktuale të punë lidhur me zbatimin e RShSNB-së në Shqipëri. Synimi ishte që ekspertët e TI-së të arrinin botëkuptim të përbashkët lidhur me situatën aktuale.

Seminari siguroi informacion me vlerë për gjendjen aktuale të zbatimit të TI-së së RShSNB-së, si dhe drejtimet kryesore që duhen ndjekur për ngritjen e infrastrukturës së TI-së plotësisht funksionale të RShSNB-së. Puna për hartimin dhe zhvillimin e kryer nga ekspertët e jashtëm të TI-së ishte shumë premtuese dhe zbatimi i kësaj pune do të jetë hap i rëndësishëm drejt RShSNB-së së administruar nga INSTAT-i. Vendimet e marra gjatë këtij seminari u paraqitën gjatë seminarit të muajit mars 2024.



Gjatë seminarit të marsit 2024, "Paraqitje e fazës aktuale të zhvillimit të TI-së, në veçanti për panelin e RShSNB-së dhe sistemin e menaxhimit të cilësisë" eksperti mbajti prezantimin e mëposhtëm sipas rezultateve të mbledhura

Plani i punës për vënien në funksion të infrastrukturës TI të RShSNB-së (rishikuar në janar) po has pengesa serioze nga sulmi kibernetik kundër INSTAT-it në shkurt dhe pasojat e tij lidhur me rikuperimin e të gjithë mjedisit të TI-së së INSTAT-it. Puna për rikuperimin po vijon dhe ka gjasa të zgjasë disa muaj, duke qenë se mjedisi i TI-së i INSTAT-it duhet të rindërtohet tërësisht hap pas hapi.

Aktualisht, nuk dihet se kur infrastruktura TI e RShSNB-së do të mund të vihet në funksion në mjedisin e TI-së së INSTAT-it. Për këtë arsye, ekipit të jashtëm të TI-së i është kërkuar të vijojë dhe përfundojë ngritjen e infrastrukturës TI të RShSNB-së (bazën e të dhënave, panelin, menaxhimin e cilësisë) në mjedisin e tyre të TI-së. Për më tepër, duhet të merret në konsideratë prokurimi i një serveri të ri të përkushtuar për RShSNB-në nga SALSTAT-i, për t'i mundësuar ekipit të jashtëm të TI-së të vërë në funksion infrastrukturën TI të RShSNB-së sa më shpejt të jetë e mundur. Sipas INSTAT-it, transferimi i një serveri të tillë të përkushtuar për RShSNB-në mund të transferohet në mjedisin e TI-së të INSTAT-n në një moment të mëvonshëm.

Sa i përket ndërtimit të infrastrukturës TI të RShSNB-së, u paraqit projekt varianti i panelit të ardhshëm të RShSNB-së dhe një sërë aspektesh të tij u diskutuan. Sistemi i menaxhimit të cilësisë është në fazë të përparuar, megjithatë zbatimi i rregullave të cilësisë nuk do të lejojë ndryshimin e të dhënave të përcaktuara në variantin aktual të rregullave të cilësisë së RShSNB-së. Për këtë arsye, rregullat e cilësisë të përcaktuara si automatizim duhet të riprojektohen për zbatim të menjëhershëm në momentin e ruajtjes së të dhënave; të gjitha rregullat e tjera të cilësisë zbatohen sipas kërkesës.

Administrimi i mbledhjes së të dhënave (vjetore) në terren për përditësimin e RShSNB-së.

U krye një diskutim fillestar lidhur me nevojën për një sistem të administrimit të mbledhjes së të dhënave (i ngjashëm me ushtrimin e përditësimit të hartës përpara Censit). Megjithatë, koncepti i mbledhjes së të dhënave në terren nuk është projektuar ende me hollësi. Supozimi është se vetëm ndërtesat me leje, në ndërtim e sipër, ose të përfunduara rishtazi duhet të kontrollohen një herë në vit nga numëruesit në terren. Për më tepër, INSTAT duhet të ketë mundësinë të shënojë godina të tjera shtesë për kontroll në terren, sipas cilësisë së të dhënave. Numëruesit duhet të kenë mundësi të futen dhe të testojnë të dhënat në kohë reale, ndërkohë që janë në terren, me qëllim konfirmimin e kontrollit të godinave të përcaktuara.

Procesi i përgjithshëm i mbledhjes së të dhënave (vjetore) në terren duhet të përshkruhet me hollësi në dokumentin ndjekës të misionit dhe do të shërbejë si element për fazën e dytë të zhvillimit të TI-së. Bazuar në njohuritë e deritanishme, fokusi i zbatimit të RShSNB-së në terren në të ardhmen duhet të jetë ofrimi i mbështetjes për numëruesit me qëllim këshillimin, ndryshimin dhe testimin e të gjitha të dhënave të RShSNB-së në kohë reale sipas nevojave të tyre.

Ecuria e mbledhjes së të dhënave në terren pritet të vëzhgohet nga stafi i INSTAT-it duke konsultuar të dhënat e RShSNB-së përmes panelit të brendshëm të RShSNB-së.

Planifikimi i veprimtarive dhe hapat e ardhshëm

Veprimtaritë themelore të vitit 2024 për zbatimin e RShSNB-së nuk kanë pësuar ndryshime:

- Ngritja e infrastrukturës TI/GIS bazë për RShSNB-së në mjedisin e TI-së të INSTAT-it
- Popullimi i bazës së të dhënave të RShSNB-së me të dhënat e Censit 2023 dhe plotësimi i RShSNB-së me adresat zyrtare nga Sistemi Kombëtar i Adresave.
- Projektimi i proceseve të mirëmbajtjes së RShSNB-së dhe përgatitja e mbledhjes së të dhënave në terren nga Zyrat Rajonale dhe Bashkitë përkatësisht.

Megjithatë, gjurmimi i veprimtarive të reja të ndërtimit në të dhënat e RShSNB-së (brenda 12 muajsh pas Censit) mund të nisë me vonesë në varësi të rikuperimit të mjedisit të TI-së së INSTAT-it.

Detyrat e mëposhtme janë identifikuar si hapat e mëtejshëm:

- 1 Përfundimi i ngritjes dhe vënies në funksion të infrastrukturës TI të RShSNB-së (faza 1) (→ ekspertë të jashtëm TI-je)
- 2 Marrja në konsideratë e prokurimit të një serveri të përkushtuar GIS për RSHSNB-në (→ SALSTAT)
- 3 Hartimi i TeR-ve të reja për infrastrukturën TI të RShSNB-së, faza 2 (→ INSTAT, SALSTAT)
- 4 Rishikimi dhe përfundimi i specifikimeve të RShSNB-së; veçanërisht lidhur me mbledhjen e të dhënave në terren (→ eksperti i SALSTAT-it)
- 5 Duhet të përgatitet transformimi i të dhënave të Censit 2023 dhe hartëzimi i të dhënave të adresave zyrtare (→ ekipi i GIS)
- 6 Duhet të përgatitet integrimi i INSTAT-it në sistemin e njoffimit e-Leje dhe legjitimimi i numëruesve të INSTAT-it në terren (→ INSTAT)
- 7 INSTAT ka bërë ndryshime të reja organizative/strukture në institucion, të cilat janë miratuar nga Kuvendi më 25 mars 2024. Në këto ndryshime, ecuria e zbatimit të RShSNB-së pasqyrohet përmes përfshirjes së RShSNB-së në Sektorin e Informacionit Gjeografik (rishtazi: Sektori i Informacionit Gjeografik dhe Regjistrin Statistikor të Ndërtesave dhe Banesave).



Sinergjia ndërmjet SALSTAT-it dhe Projektit Bashki të Forta të HELVETAS-it

Më 22 shkurt 2024 u zhvillua në Tiranë "Takimi hapës për statistikat e arsimit parashkollor në nivel bashkie, ndërmjet SALSTAT/INSTAT dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar Zviceran Helvetas. Takimi u mbajt me qëllim përcaktimin e nevojave për statistika në nivel bashkie për fëmijët 0 deri 6 vjeç, pra fëmijët në çerdhe dhe në arsimin parashkollor, ndërkohë që planifikohet hartimi i një pyetësoi të dhënash përmes internetit për bashkitë.

Aktualisht, ka vetëm një tregues për arsimin parashkollor për fëmijët 3 deri 6 vjeç që botohet nga INSTAT në nivel bashkie: Numri i fëmijëve të regjistruar. Për çerdhet (0-3 vjeç) nuk mbledhen të dhëna.

Synimi është të shtohet numri i treguesve të botuar në nivel bashkie për arsimin parashkollor.

- INSTAT-i përgatiti projekt dokumentin e pyetësoit për të dhënat/treguesit për arsimin parashkollor, përfshirë kopshtet dhe çerdhet në nivel bashki, dhe planifikohet që SALSTAT - INSTAT së bashku me ekspertin vendore që mbështet SALSTAT-in për administrimin e objektivave dhe procesin e monitorimit të projektit bazuar në udhëzimet e SDC-së për kontrollin dhe matjen e cilësisë së progresit, të vizitojnë disa bashki pilot për të kontrolluar dhe plotësuar pyetësoin e statistikave të arsimit parashkollor në nivel bashkie.



Organizimi / zhvillimi i trajnimeve sipas Modulit 3: Njohuri për tabulimin dhe analizimin e të dhënave (nivelet fillestare dhe të avancuara në Excel)

Në kuadrin e Rezultatit 3 - Bashkitë mbështeten për zhvillimin e kompetencave dhe kapaciteteve të tyre statistikore dhe janë më të ndërgjegjshme për rolin e statistikave zyrtare në Shqipëri, SALSTAT-i organizoi trajnimin për programin Microsoft Excel për stafin e bashkive në datat 9 deri 13 tetor 2023, në ambientet e INSTAT-it.

Trajnimet u organizuan në grupe me përfaqësues nga secila bashki dhe në tabelën 1 paraqiten ditët e trajnimit dhe pjesëmarrja sipas grupeve.

Gjithsej u trajnuan 88 punonjës të bashkive nga të cilët 58 ose 69% ishin gra.

Në fund të trajnimit, çdo pjesëmarrës plotësoi raportin e vlerësimit me pyetjet e mëposhtme (përfshirë pyetje nga UN Women në Shqipëri mbi Statistikat Gjinore).

Gjetjet e vlerësimit treguan se trajnimi ishte me përfitim dhe i dobishëm për pjesëmarrësit dhe se ata janë shumë të interesuar të trajnohen më tej për analizimin e të dhënave.

Rezultatet e vlerësimit do të diskutohen gjithashtu brenda për brenda ndërmjet INSTAT/SALSTAT dhe UN Women në Shqipëri. Përfundimet do të mbështesin përmirësimin e trajnimeve të mëtejshme për bashkitë.



Analizat e të dhënave të Censit sipas nevojave të INSTAT-it, përfshirë treguesit e rinj të mundshëm në nivel bashkie

Pas Censit të vitit 2023, gjatë marsit të vitit 2024 nisi një mandat ndërkombëtar lidhur me Vlerësimin e statistikave të migracionit me të dhënat e Censit të vitit 2023 dhe zbatimin / testimin e një modeli për vlerësimin e migracionit dhe popullsisë.

Mandati në fjalë bazohet në punën dhe mbështetjen ekzistuese për INSTAT-in dhe në përdorimin e të dhënave të Censit të vitit 2023 nga SALSTAT-i për arritjen e objektivave të mëposhtëm:

Vlerësimin me qëllim shpërndarjen e statistikave të migracionit (së jashtmi dhe së brendshmi) bazuar në Censin e vitit 2023, dhe përcaktimin e studimeve të mundshme të migracionit. Duhet të bëhet dallim i qartë ndërmjet analizës dhe shpërndarjes së informacionit në periudhë afatshkurtër (me gjasë tregues përkthues) dhe këndvështrimit afatmesëm (me gjasë studime të migracionit).

- Tregues për migracionin e brendshëm me karakteristikat përkatëse të popullsisë (variablat) në nivel rajonal dhe vendor
- Tregues për migracionin ndërkombëtar/të jashtëm me karakteristikat përkatëse të popullsisë (variablat) në nivel rajonal dhe vendor
- Përshkrimi i studimeve të mundshme për migracionin (e brendshëm dhe të jashtëm) duke përdorur kryesisht Censin e vitit 2023

Testimi dhe zbatimi së bashku me INSTAT-in i modelit të zhvilluar për vlerësimin e migracionit (të jashtëm dhe të brendshëm) dhe për t'i mundësuar INSTAT-it të shpërndajë treguesit kyçë për migracionin (e brendshëm/të jashtëm) edhe në nivel rajonal (12 qarqet) dhe vendor (61 bashkitë) duke përdorur Censin e vitit 2023 dhe burime të tjera të dhënash:

- Ekspertiza e nevojshme teknike duhet të mundohet të punojë me INSTAT-in me qëllim përdorimin e burimeve të të dhënave të përdorura për zbatimin e modelit të zhvilluar të vlerësimit.
- Modeli për vlerësimin e migracionit synon të japë rezultate për nivelin rajonal dhe nëse është e mundur edhe atë vendor. Për këto arsye, diskutimi duhet të përfshijë pyetje për çështjet e besueshmërisë, konfidencialitetit dhe cilësisë lidhur me botimin e treguesve të nivelit vendor (bashki) dhe rajonal (qark).

- Bazuar në diskutimet dhe testimet duhet të përcaktohet së bashku me INSTAT-in një afat kohor (kalendar) për shpërndarjen e treguesve kyçë (kombëtarë, rajonalë dhe vendorë) duke zbatuar modelin e ri çdo vit.

Në fund të këtij viti pritet të vihet në dispozicion një raport i shkurtër përfundimtar mbi kapacitetet e INSTAT-it për të zbatuar modelin, si dhe mundësitë e INSTAT-it për shpërndarjen e statistikave të migracionit, së bashku me disa rekomandime për arritjen e objektivit në fjalë.

Gjithashtu, rezultatet do të përdoren për botimin e planifikuar të rezultateve të Censit në nivel bashkie, që planifikohet për tremujorin e fundit të vitit 2024.

JU FALËNDEROJMË QË LEXUAT BULETININ TONË INFORMATIV!

EKIPI I SALSTAT

Menaxher projekti:

Martin Teichgräber, Zyra Federale Zvicerane e Statistikave

Koordinatorë:

Alketa Doçi, Koordinate për Regjistrat dhe të Dhënat Administrative

Eralda Pushaj, Koordinate me Njësitë e Qeverisjes Qendrore

Edlira Çeliku, Koordinate Administrative dhe Financiare